

Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor, 2015

Tiranë, më 08 Janar 2016: Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Dhjetor 2015, arriti 119,3 % kundrejt muajit Dhjetor 2007 (Dhjetor 2007=100).

Në muajin Dhjetor 2015 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 2,0 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 0,7 %.

Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore në muajin Dhjetor 2015 është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +2,0 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar me +0,12 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” kanë kontribuar me +0,07 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene e restorante” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje, çmimet e grupit “Argëtim e kulturë” kanë kontribuar me +0,03 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” kanë kontribuar me -0,32 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” kanë kontribuar me -0,17 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me -0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Shëndeti” dhe “Komunikimi” kanë kontribuar me nga -0,03 pikë përqindje secili. (shih Fig 2. fq 2).

Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Dhjetor 2014, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 5,1 %, pasuar nga grupi “Shërbimi arsimor” me 4,8 %, grupi “Pije alkoolike dhe duhan” me 3,3 %, etj. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 23,9 %, pasuar nga nëngrupi “fruta” me 22,7 %, nëngrupi “vajra dhe yndyrma” me 1,8 %, nëngrupi “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” me 1,0 %, etj. Çmimet e nëngrupit “qumësht, djath e vezë” u ulën me 5,8 %, pasuar nga nëngrupet “mish” dhe “kafe, çaj e kakao” me nga 0,8 %, etj. Ndërsa, ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Veshje dhe këpucë” me 3,2 %, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 2,0 %, “Komunikimi” me 1.1 %, etj.


Ndryshimi mujor i indeksit është 0,6 %. Krahasuar me muajin Nëntor 2015, rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije alkoolike” me 1,3 %. Krahasuar me muajin e mëparshëm çmimet e eurodiezelit u ulën me 1,6 % dhe çmimet e benzinës me 1,2 %.

Për publikim 08/01/2016

Fig.1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit



Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Shënim: Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit shpreh kontributin që jep secili grup shpenzimesh në ndryshimin vjetor të shprehur në pikë përqindje. Shuma e kontributeve me vlera pozitive dhe negative jo domosdoshmërisht jep ndryshimin vjetor për shkak të rumbullakimeve gjatë procesit të llogaritjeve. Psh. edhe pse indeksi i grupit "Pije alkoolike dhe duhan" në muajin Dhjetor 2015 u rit me 3,3 % , kontributi në ndryshimin vjetor është + 0,12 pikë përqindje.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2007=100 %

Kodi	Grupet	Peshat	12-14	01-15	02-15	03-15	04-15	05-15	06-15	07-15	08-15	09-15	10-15	11-15	12-15
Gjithsej		100,0	117,0	118,6	121,4	121,9	121,3	119,4	118,1	117,3	118,2	118,9	118,9	118,5	119,3
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	39,3	125,8	129,9	137,0	138,4	137,2	132,2	129,2	127,2	129,7	131,3	131,3	130,5	132,2
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,6	143,9	144,6	146,0	146,5	147,3	147,6	148,0	147,5	147,8	147,8	148,0	147,6	148,6
3	Veshje dhe këpucë	5,1	85,7	85,6	84,1	83,5	83,4	83,2	82,8	82,3	81,6	81,7	82,3	82,8	82,9
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	16,3	115,7	115,9	115,8	115,3	113,6	113,5	113,7	113,8	113,8	113,8	113,5	113,4	113,5
5	Mobilim, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	10,0	103,1	103,1	102,9	102,9	103,1	103,2	103,1	103,1	103,3	103,1	103,0	103,1	103,7
6	Shëndeti	3,4	114,9	115,7	116,6	116,6	117,1	117,1	113,4	113,9	113,9	114,2	114,4	113,9	113,9
7	Transporti	6,1	116,6	114,9	115,7	116,8	117,8	118,1	118,6	119,0	118,2	117,2	117,2	115,9	115,9
8	Komunikimi	2,6	83,0	83,0	82,9	82,9	83,0	83,0	83,0	83,0	82,1	82,1	82,1	82,1	82,1
9	Argëtim dhe kulturë	3,1	114,8	115,0	115,5	115,4	115,4	115,4	115,3	114,8	115,0	116,1	116,4	116,3	116,1
10	Shërbimi arsimor	1,4	121,2	121,2	121,2	121,2	121,2	121,2	121,2	121,2	121,7	122,2	127,0	127,0	127,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,2	112,5	112,6	112,6	112,6	112,6	112,6	112,7	112,7	112,8	113,7	113,7	113,6	113,7
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,9	115,7	115,6	115,4	115,3	115,8	115,9	115,8	115,3	115,1	116,2	115,6	115,9	115,4

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	12-14/12-13	01-15/01-14	02-15/02-14	03-15/03-14	04-15/04-14	05-15/05-14	06-15/06-14	07-15/07-14	08-15/08-14	09-15/09-14	10-15/10-14	11-15/11-14	12-15/12-14
Gjithsej		0,7	1,3	2,3	2,2	2,3	1,8	1,4	1,3	1,9	2,2	2,1	2,1	2,0
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	0,4	2,2	4,8	4,7	5,2	3,8	2,7	2,4	4,2	4,9	5,5	5,9	5,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	7,1	4,6	6,3	6,3	6,5	6,8	7,0	6,6	6,7	6,9	6,1	3,3	3,3
3	Veshje dhe këpucë	0,1	0,1	-0,2	-0,9	-1,3	-1,2	-1,3	-1,0	-1,6	-2,1	-3,7	-4,0	-3,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,5	0,7	0,7	0,3	-1,0	-0,8	-0,4	-0,3	-0,3	-0,2	-1,4	-1,7	-2,0
5	Mobilim, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,3	-0,2	-0,5	-0,1	-0,3	-0,1	-0,1	-0,1	-0,1	-0,1	-0,4	0,0	0,6
6	Shëndeti	-5,6	-5,2	-4,5	-4,4	-1,5	0,1	-1,9	-0,8	-0,9	-0,6	-0,5	-1,3	-0,9
7	Transporti	-1,1	-3,7	-3,3	-2,2	-1,5	-1,4	-1,1	-0,9	-1,9	-2,5	-2,1	-2,8	-0,6
8	Komunikimi	3,9	3,8	3,7	3,7	2,3	2,2	2,2	1,7	0,6	0,0	0,0	-0,8	-1,1
9	Argëtim dhe kulturë	0,1	0,5	0,7	0,6	0,5	0,5	0,4	0,1	0,2	0,4	1,0	1,0	1,1
10	Shërbimi arsimor	11,2	11,0	10,2	10,3	10,1	10,1	10,1	10,1	10,4	10,5	4,8	4,8	4,8
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,5	1,6	1,4	0,6	0,6	0,5	0,4	0,3	0,5	0,8	0,6	0,7	1,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	3,1	2,9	-1,3	-1,7	-1,1	-1,0	-0,8	-0,7	-0,7	-0,1	-0,6	-0,1	-0,2

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

Kodi	Grupet													%
		12-14	01-15	02-15	03-15	04-15	05-15	06-15	07-15	08-15	09-15	10-15	11-15	12-15
	Gjithsej	0,7	1,4	2,4	0,4	-0,5	-1,6	-1,1	-0,7	0,8	0,6	0,01	-0,3	0,6
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,0	3,3	5,4	1,0	-0,8	-3,6	-2,3	-1,5	2,0	1,2	-0,1	-0,6	1,3
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,7	0,5	1,0	0,4	0,5	0,2	0,3	-0,3	0,2	0,0	0,1	-0,2	0,6
3	Veshje dhe këpucë	-0,6	-0,1	-1,7	-0,7	-0,1	-0,3	-0,5	-0,5	-0,9	0,1	0,8	0,5	0,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,3	0,1	0,0	-0,5	-1,5	-0,1	0,2	0,0	0,0	0,0	-0,3	0,0	0,0
5	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,0	0,0	-0,2	0,1	0,1	0,1	-0,1	0,1	0,1	-0,2	-0,1	0,1	0,5
6	Shëndeti	-0,4	0,7	0,7	0,0	0,4	0,0	-3,1	0,4	0,0	0,3	0,2	-0,5	0,0
7	Transporti	-2,2	-1,5	0,7	1,0	0,8	0,3	0,4	0,4	-0,7	-0,8	0,0	-1,2	0,0
8	Komunikimi	0,3	0,1	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-1,1	0,0	0,0	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	-0,2	0,2	0,4	-0,1	0,0	0,1	-0,1	-0,4	0,2	0,9	0,2	-0,1	-0,1
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,4	0,5	3,9	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	-0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,2	0,8	0,0	-0,1	0,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,2	-0,1	-0,2	-0,1	0,5	0,1	-0,1	-0,4	-0,2	0,9	-0,4	0,2	-0,4

Informacion për përdoruesit

INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT ME SHPORTËN E RE TË MALLRAVE

Instituti i Statistikave njofton të gjithë përdoruesit se më 10 Shkurt 2016 do të publikojë Indeksin e Çmimeve të Konsumit me shportën e re të mallrave.

INSTAT, aktualisht publikon Indeksin e Çmimeve të Konsumit mbështetur në peshat e gjeneruar nga rezultatet e Anketës së Buxhetit të Familjeve (ABF) 2006-2007. Si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit është konsideruar muaji Dhjetor 2007, (Dhjetor 2007=100).

INSTAT, duke filluar nga muaji Janar 2016, do të publikojë Indeksin e Çmimeve të Konsumit, duke përdorur një shportë të re mallrash dhe shërbimesh bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjeve 2014.

Indeksi i ri do të llogaritet duke konsideruar si periudhë bazë muajin Dhjetor 2015, (Dhjetor 2015=100).

Indeksi i ri, në konceptin e peshave, do të vazhdojë të mbulojë të gjithë territorin e vendit ashtu si indeksi i mëparshëm.

Indeksi i Rinovuar i Çmimeve të Konsumit do të vazhdojë të publikohet në nivel vendi më datë 8 të muajit pasardhës në faqen e Web-it të INSTAT në adresën www.instat.gov.al.

Në faqen e Web-it të INSTAT, www.instat.gov.al, gjithashtu do të gjeni serinë kohore të indekseve në nivele më të detajuar. Të gjitha indeksat e mëparshme do të rillogariten dhe publikohen me bazën e re (Dhjetor 2015=100).

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), duke filluar nga muaji Dhjetor 2007 llogaritet me shportën e artikujve, peshat e të cilave janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës së Buxhetit të Familjes, realizuar nga INSTAT gjatë periudhës Tetor 2006-Shtator 2007. Muaji Dhjetor 2007 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2007 = 100). Ndryshimi i mëparshëm i shportës së artikujve është bërë në muajin Janar të vitit 2002, ku numri total i artikujve u rrit nga 221 në vitin 1993 në 262 artikuj. Në shportë numri total i artikujve është 272. Indeksi llogaritet dhe publikohet duke përdorur strukturën e Klasifikimit të Shpenzimeve sipas Qëllimit (COICOP) me 12 grupe kryesore, tërësisht të përputhshëm me klasifikimin e shpenzimeve që përdor EUROSTAT.

Peshat e artikujve janë llogaritur për çdo prefekturë duke marrë në konsideratë shpenzimet e familjeve qytetare dhe fshatare, kështu indeksi mbulonë gjithë territorin e vendit (qytet-fshat) ndryshe nga indeksi i mëparshëm që llogaritej vetëm për zonën urbane. Çmimet e artikujve mbledhen në 11 qytetet-prefekturë, ku prefektura Kukës përfaqësohet nga prefektura Dibër. Çdo artikull i shportës përfaqësohet në indeks me peshën e tij gjeografike. Indeksi i ri do të vashdojë të publikohet vetëm në nivel kombëtar.

Për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Shqipëri përdoret formula e Laspeyres:

$$I_{0,i}^t = \frac{\sum_i P_i^t * Q_i^0}{\sum_i P_i^0 * Q_i^0}$$

Peshat ($w = P*Q$) e periudhës bazë janë përdorur për llogaritjen e indeksit:

$$I_{0,i}^t = \sum_i w_i * \left(\frac{P_i^t}{P_i^0} \right)$$

Në mënyrë më të detajuar, çmimi relativ është llogaritur për çdo produkt dhe çdo prefekturë duke përdorur mesataren gjeometrike :

$$PR_{t-1,ij}^t = \prod_{k=1}^n \left(\frac{P_{ijk}^t}{P_{ijk}^{t-1}} \right)^{1/n}$$

Ndryshimet mujore zinxhir japin çmimet relative krahasuar me periudhën bazë:

$$PR_{0,ij}^t = PR_{0,ij}^1 * \dots * PR_{t-1,ij}^t$$

IÇK rajonale llogaritet si më poshtë.

$$RIÇKI_{i,0}^t = \sum_i r_{ij} * PR_{0,ij}^t$$

Çmimet relative agregohen me peshat gjeografike për të formuar indekset e çdo produkti për gjithë Shqipërinë.

$$I_{0,i}^t = \sum_j r_{ij} * PR_{0,ij}^t \quad \text{ku:} \quad \sum_j r_{ij} = 1 \quad : \quad \forall_i \text{ (për të gjitha rastet)}$$

Agregimi për të gjitha produktet jep IÇK e Shqipërisë:

$$CPI_0^t = \sum_i w_i * I_{0,i}^t \quad \text{ku:} \quad \sum_i w_i = 1$$

Legjenda:

P	çmimi
PR	çmimi relativ
I	indeksi
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
t	periudha korente t
t=0	periudha bazë 0
r	peshat gjeografike
ë	peshat e produkteve
j	numri i prefekturave
i	numri i produkteve

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.